




REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Mr. Prot. 2-18012482
Nr. i llog. 2
Data 08/05/2020



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/06/2020
Datë: 07.05.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12,2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr: 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr: 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22,1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 30.04.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për

ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake të vitit 2019

I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për ndryshimin e planit të buxhetit për shkak të rritjes së të hyrave vetanake gjatë vitit 2019 sipas tabelës dhe sqarimit në vijim:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi vjetor 2019	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	32,017.75	38,032.00	6,014.25
2	Te hyrat nga urbanizmi	11,200.00	14,391.99	3,191.99
3	Te hyrat nga administrata	6,200.00	7,630.00	1,430.00
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	4,500.00	15,319.36	10,819.36
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	53,926.00	72,283.09	18,357.09
6	Regjistrimi i Automjeteve	7,600.00	5,918.00	-1,682.00
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,200.00	6,999.90	799.90
8	Të hyrat tjera	16,700.00	26,326.50	9626.50
	TOTALI	138,343.75	186,900.84	48,557.09

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Dhjetor 2019 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **186,900.84€**. Shuma e planifikuar për vitin 2019 është **113,557.00€**, gjatë vitit 2019 është bërë ndryshimi i këtij plani në shumë prej 24,786.75, Totali i planifikimit pas këtij ndryshimi është **138,343.75€** ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2019 në vlerë prej **48,557.09€** në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga Gjobat në trafik në shumë prej **7,085.00€**.

Në mënyrë që të mundemi ti alokojmë tejkalimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **48,557.09€**, totali i të hyrave për vitin 2019 të rritet nga 138,343.75€ në 186,900.84€.

Kjo rritje në vlerë prej **48,557.09€** të bartet në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i projekteve me kod të projektit 46030.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me ndryshimet e planit të buxhetit për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2019, nga pika I. e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

